VENDIM
Nr. 17, datë 27.7.2022

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror'", të ndryshuar; kreu III, neni 13, pika "b", në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror'"; kreu II, neni 4, pikat "a", "c"; dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, "Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror', Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018, të kryetarit të Autoritetit, "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar 'Sekret shtetëror', të ndryshuar në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 17, datë 17.7.2022, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. **Dosje personale nr. 15968**, në ngarkim të F.T., me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 10 (dhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

2. **Dosje pune nr. 15968**, në ngarkim të F.T., me 4 (katër) fletë, të cilat janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

KRYETAR
Gentiana Sula